

***AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ARON-18” sh.p.k.***

Në Tiranë, sot më datë 25/08/2024:

Z. Altin Dakoli, shtetas Shqiptar, lindur ne Durrës, Shqiperi, me 07.08.1970 dhe banues ne adresen Rruga "Andon Zako Cajupi", Tiranë Shqipëri, mbajtës i pasaportes biometrike me nr. ZH008070950 dhe nr. Personal **H008070950**.

Në cilësinë e "ortakut themelues" ka rene dakort per hartimin e këtij akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklaron se me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqeritë tregtare", ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqerinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, "ARON-18" sh.p.k

**NENI 1
EMËRTIMI I SHOQËRISE**

Themelohet shoqëria me emrin "**ARON-18**" sh.p.k, Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do t'i nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelues dhe Statutit të shoqërisë të miratuar nga ortaku dhe në përpithje me legjislacionin shqiptar në fuqi, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

**NENI 2
PERSONALITETI JURIDIK**

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB (Qëndra Kombëtare e biznesit), në përpithje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqëria "**ARON-18**" SHPK, është një shoqëri tregtare me përgjegjesi të kufizuar.

**NENI 3
SELIA E SHOOOËRISË**

Shoqëria e ka selinë në Njesine Administrative nr 5, Rrugën "Andon Zako Cajupi", Nr 3/C3, Tirane.


Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, edhe nëpërmjet vendimit vetëm nga Administratori si edhe të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

**NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria ka për objekt:

Shoqëria tregtare me përgjegjësi te kufizuar "Aroni" ShPK, mund të kryeje çdo llojë aktivitet të lejuar me ligj në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë pa kufizime në të gjitha fushat si në ndërtim, shërbime, transport- mallrash,- transport = inertesh,- shitje-blerje makinash, auto- servisë, bar - kafe dhe lavazh,-shërbime telemarketingu ose marketing online etj, në të gjitha fushat e mësipërme por duke mos ulimituar në to; Ndërtim baneshash shumë katesh dhe resorte turistike, Shitje- Blerje material ndërtimi. Turizëm dhënie me qira pronash (Real ESTATE).

- Import- eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice të bimëve medicinal si dhe grumbullimin e tyre, artikujve te ndryshëm farmaceutike e kozmetike, të lendeve të përpunuara dhe të papërpunuara për prodhime farmaceutike sipas ligjeve në fuqi. ë.
- Shitje , tregimi, qiradhënie dhe mirëmbajtja , transporti I impianteve sanitare të lëvizshme, kimike dhe ekologjike ose wc të lëvizshme pastrim dezinfektim, dizinfektim I banjove të lëvizshme ose fikse të strukturave të tjera publike dhe private;



Realizimi, shitja dhe tregtimi i produkteve për higjienën mjedisor ose humanitare me te gjitha njësitë të lëvizshme ose fikse.

- Shërbim pastrim dhe mirëmbajtje te impianteve të brenshëm dhe të jashtëm: industrial dhe civile, publike dhe private. Pastrim të përditshme, pastrim special, pastrim pas ristrukturimit, lyerjes etj. Lavazh, pastrim, trajtim dhe lublifikim të dyshemeve të çdo lloji dhe të çdo lartësie. Pastrim dhe lavazh i kolltukëve, divanëve, karrigeve, tapeteve, motoçikletave, tendave të holla dhe të trasha, grilave etj, të çdo lloji dhe përmase.
- Shërbime lavanderie dhe hotelerie, larje, hekurosje të çdo lloj dhe transport i materialeve të pastra. Shërbime autolavazhi për çdo lloj mjeti. Pastrim dhe dezinfektim (ODD) të strukturave spitalore te brendshme dhe të jashtme me rrezik te ulet, te mesëm dhe të lartë.
- Vleresim i impaktit mjedisor dhe audit mjedisor, hartim i akt ekzperitimeve, raporteve etj. Tregtim (Shitblerje), furnizim, importim shumice dhe pakice te detersive, produkteve, materialeve, pajisjeve, vëglave, aksesoreve, makinave te pastrimit.
- Shërbim mirëmbajtje gjelberimi e bimëve zbukuruese, krasitje, mbjellje dhe zëvendësim lulesh, biësh dhe pemësh. Transport mallrash dhe produkesh për ente te ndryshme.
- Transport, grumbullim dhe heqje e mbetjeve urbane, pastrim qyteti, fshati, etj., dhe trajtim e riciklimin e mbetjeve. Grumbullim, transporti për djegien e mbetjeve spitalore të rrezikshme.
- Realizimin dhe mirëmbajtjen e impianteve për djegien e mbetjeve. Trajtimin dhe djegien e mbetjeve urbane spitalore. Ripërdorimin e materialeve, paketim dhe prodhim i lendeve djegëse nga mbetjet. Pastrim me mjete teknike të posaçme uji, transport i materialeve të pastra. Pastrim i gropave skeptike të çdo lloji, me transportin e ujërave të zeza.
- Shërbim i Ndërhyrjes Higjeno-Sanitare, Shërbim Dezinfektimi (DDD-Dezinfektimi-Dezinfektimi -Deratisim)- të çdo lloj mjedisë të brendshëm dhe të jashtëm, publik dhe privat, të spitaleve dhe qendrave shëndetësore të çdo lloj subjekti; heqjen e gjarpërinjce, qenve, maceve, minjve të fshatit, mizave dhe insekteve, pemëve dhe bimëve.
- Impotin dhe tregtimin e produkteve për trajtimin DDD dhe heqjen e gjarpërinjve, qenve, maceve, etj. Prodhim dhe tregtime me shumice dhe pakice e pesticideve (PPP)
- Prodhim dhe tregtim me shumice dhe pakicë të farërave, bimëve, luleve etj.
- Shitblerje, import, qiradhënie të vinçave për ngritjen e peshave, autoklavave, makinerive për ngritje vinçave me kosh dhe çdo lloj platfime ajrore tjetër.
- **Sherbime për lyerjen, pastinimin, stukimin në çdo lartesi. Ndërtimë civile dhe ekonomike ristrukturim të ndërtesave deri ne 5 kate.**
- Pastrim impianteve të aspirimit-kondicionimit(HVAC-Ngrohje, Ventilim dhe Kondicionim, kapat e kuzhinës, pajisjeve te impianteve industrial, restoranteve, hoteleve, lavanderive(larje e thatë) qendra tregtare, spitale, apartameteve e banesave private etj.
- **Sherbime elektrike** dhe Tregtimin e materialeve elektrike. Shërbime hidraulike dhe tregtimin e materialeve hidraulike, ndërtimin e ristrukturimin e ndërtesave publike dhe private, ristrukturimin dhe mirëmbajtjen e te gjitha impianteve duke perfshire segmente rrugore, mirëmbajtje e ndërtesave publike dhe private, shitjen dhe furnizimin e aparaturave dhe materialeve për impiantet elektrike, laboratori, spitali me shumicë dhe pakicë.



Për realizimin e veprimitarisë dhe arritjen qellimit, shoqëria mund të ushtrojë veprimtari të tjera: të çdo lloj operacioni tregtar, industrial dhe financiar të luajtshëm dhe te paluajtshëm, duke përfshire ndërtimin, shitjen dhe administrimin e pasurive të paluajtshme që lidhen me objektin e veprimitarisë.

Shoqëria do te ketë si objekt të veprimitarisë së saj kryerjen e çdo operacioni ekonomik dhe ligjor (të brenshëm dhe të huaj) të lejuar nga legjislacioni shqiptar në përputhje me obkjetin e veprimitarisë së saj dhe që do të jenë të rëndësishme për të ardhmen e shoqërisë.

NENI 5 **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit (QKB).

NENI 6 **KAPITALI THEMELTAR I SHOOËRISË**

Kapitali i shoqërisë tregtarë është 1.000.000 Lekë (një million leke). Kapitali i shoqërisë është i përbërë nga 1 kuotë me vlerë, si me poshtë:

Z. Altin Dakoli, zoterues e 1 (një) kuote që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërise me vlerë 1.000.000 Lekë (një million leke).

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë te tregëtueshme.

Kapitali fillestar i shoqërisë mund të rritet apo zvogëlohet dhe është totalisht i likuidueshëm dhe i nënshkrueshëm.

Ortaku i vetëm i shoqërisë angazhohet me detyrën për te shtuar volumin e veprimitarisë se shoqërisë, të respektojë detyrimin e ruajtjes së sekretit të saj lidhur me tipologjinë e aktivitetit të saj tregtar dhe të mos dëmtojë interesat e shoqërisë.

NENI 7 **TRANSFERIMI I KAPITALIT**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- c) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- e) orkaku ka te drejtë t'jua trashgojë kuotat e tij bashkëshortes/bashkëshortit dhe fëmijëve.
- f) në rast se ortaku dëshiron të shes një pjese të kuotave mund ta bëjë në çdo moment dhe gjithashtu nëse në të ardhmen do të behet mer ortak pavaresisht % (perqindjes) se kuotave që do të gezoje në momentin që do të vendosi për të shitur kuotat përkatese, duhet tu japi prioritet fillimisht ortakeve te tjere nese do të ketë në të ardhmen pëse ata do të jene te interesuar ne blerjen e tyre, nese asnjë nga ortakët nuk shfaq interes ai ka të drejtë të shesi kuotat e veta paleve të treta te interesuara.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombëtare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 8 **ORGANI VENDIMMARRËS**

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm ne rast se shoqeria është e themeluar nga një ortak i vetem. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendlod për çështje si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat epermendor në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- j) miratimin e pasqyrave finançiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- k) shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- l) investime;
- ll) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- m) te bleje, shese, kembeje pasuri te patundshme te shoqerise;
- n) per shperndarjen e fitimit.

Vendimet e paregjistroara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtjojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku/ortaket registrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

NENI 9 ADMINISTRIMI

Z. Altin Dakoli, shtetas Shqiptar, lindur ne Durres, Shqiperi, me 07.08.1970 dhe banues ne adresen Rruga "Andon Zako Cajupi", Tiranë Shqipëri, mbajtës i pasaportes biometrike me nr. ZH008070950 dhe nr. Personal **H008070950** emëruar në këtë detyrë për një afat 5 (pesë) vjeçar duke filluar nga data 25/08/2024 deri me datë 25/08/2029.

Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim te Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 10 KOMPETENCAT

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruej bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpérndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Të hape llogari bankare dhe të operoje për llogari të kompanisë pa limit.
- f) të kërkojë financime pa limit për kompaninë nga banka apo institucionet e tjera financiare;
- g) raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare
- h) të blejë dhe të shesë, në emër të shoqërisë, produkte dhe çdo gje tjeter si brenda territorit te Shqipërisë ashtu dhe jashtë territorit të saj;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblesë së përgjithshme edhe në rastet kur :
sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që
kanë vlerë më të lartë se 5 (pese) për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit

financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqerinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhëniet me tē tretët nē emër të shoqërisë, nē të gjitha rr Ethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerinë nē marrëdhëniet me tē tretët nē përmjet akteve që janë nē përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj tē tretëve kur ajo provon se tē tretë e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur tē tretë nuk mund ta injoronin këtë akt nē rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

NENI 11

VITI FINANCIAR DHE FITIMET E SHOQËRISË

Viti finansiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë finansiar që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë nē QKB dhe mbyllt më 31 Dhjetor.

Fitimet e shoqërisë i takojnë ortakut të saj. Asambleja sipas ligjit vendos për ndarjen ose riqarkullimin e tyre duke përcaktuar edhe modalitetet për këtë procedurë.

NENI 12

SHPËRNDAJJA OSE PRISHJA E SHOQËRISË

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund tē bëhet nē çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar nē themelimin e saj;
- b) me vendim tē asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave tē falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtarë për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë nē përputhje me pikën 3 tē nenit 43 tē ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim tē gjykates;

Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim nē tē cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar nē çdo dokument tē nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqeri nē likuidim e sipër ".

NENI 13

EMËRIMI DHE SHKARKIMI I ADMINISTRATORËV

Asambleja e përgjithshme emëron dhe revokon administratorin ose administratorët nē fuqi dhe mund tē emëroje edhe administratorë te tjerë me detyra te përcaktuara me ligj dhe nē autorizim.

Administratori do te ushtrojë tē gjitha kompetencat e parashikuara me ligj, për administrimin e zakonshëm tē shoqërisë, tē përfaqësojë shoqerinë nē marrëdhëniet me tē tretët me përjashtim të kompetencave qe vete ligji apo statuti u jep shprehimisht ortakeve.'

Për çështje tē rendësishme tē veçante administratori konsultohet me ortakun dhe merr masat e përcaktuara, te marra me shumicat e parashikuara me ligj.

NENI 14

TABELA, MARKA DHE SHENJA DALLUESE

Shoqëria ka vulën e saj me përmasa tē zakonshme, tē realizuar sipas parashikimeve tē ligjit nē fuqi dhe mund tē ketë një marke te veten.

NENI 15 **BAZA LIGJORE**

Shoqëria do tē zhvillojë aktivitetin e saj nē përputhje tē plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet nē këtë akt themelimi, do tē zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtarë", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik nē Republikën e Shqiperisë.

NENI 16 **JURIDIKSIONI**

Për tē gjitha konfliktet që mund tē lindin midis ortakut/ëve dhe Shoqërisë dhe administratorit do tē jetë kompetent juridikioni i Republikës së Shqipërisë, me zbatimin e ligjeve shqiptare.

NENI 17 **LIGJI I ZBATUESHËM**

Shoqëria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanërisht te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 18
REGJISTRIMI

Ky Akt Themelimi i Shoqërisë do të hyjë në fuqi pas regjistrimit, në regjistrat përkatës, nga organet publike kompetente.

Neni 19
Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 kopje në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera të njëjta juridike. Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare "ARON-18" sh.p.k , nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre orgjinale.

**ORTAKU I SHOQERISE
"ARON-18" SHPK**

ALTIN DAKOLI

